



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER

Nr. \_\_\_\_/\_\_\_\_Prot.

Fier, më \_\_\_\_08.2025

**Lënda:** Formulari i njoftimit të fituesit në përfundim të afateve të ankimit për procedurën me objekt  
“Blerje autoboti për nevoja të Bashkisë Fier”, me burim financimi nga buxheti i shtetit  
dhe buxheti i Bashkisë Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK  
TIRANË  
(për botim)

Shtojca 12

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

**Data:** 20.08.2025  
**Drejtuar:** Operatorit Ekonomik START CO SHPK  
**Adresa:** Tiranë, Bulevardi “Gjergj Fishta”, Kulla “G&P”, Kati 1  
**NUIS:** L11614001S

**Tipi i Kontratës:** Mall

**Lloji i Procedurës së prokurimit:** Procedurë “e hapur”, me mjete elektronike mbi kufirin e lartë  
monetare, me objekt “Blerje autoboti për nevoja të Bashkisë Fier”

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-47385-05-08-2025.

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:**

“Blerje autoboti për nevoja të Bashkisë Fier”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej 17 146  
050 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH ose  
fondi limit në Euro (sipas kursit të këmbimit nga BSH datë 08.05.2025): 174 621.14 (një  
qind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e njëzetë e një pikë katërmëdhjetë) Euro ,  
vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit dhe Buxheti i Bashkisë Fier.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 180 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **27.06.2025**

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit, **Buletini Nr. 33 datë 30 Qershor 2025**

#### Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto ☐
- ☐ oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

\* \* \*

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këtë vlerë përkatëse të ofruar:

1. Operatori ekonomik ALBANIA MOTOR COMPANY SHPK, me NIUS K41829010I. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 13 900 000 (*trembëdhjetë milion e nëntëqind mijë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori ekonomik ALMETA GMBH SHPK, me NUIS K22013001U. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 16 700 000 (*gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind mijë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
3. Operatori ekonomik MEKTRIN MOTORS SHPK, me numër NUIS K51408501P. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 15 732 000 (*pesëmbëdhejtë milion e shtatëqind e tridhjetë e dy*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
4. Operatori ekonomik START CO SHPK, me NUIS L11614001S. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 12 877 000 (*dymbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
5. Operatori ekonomik TIMAK SHPK me NUIS L62030020B. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 16 735 000 (*gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë*) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

#### **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

##### **❖ Operatorin ekonomik ALBANIA MOTOR COMPANY SHPK, me NIUS K41829010I.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesmarrës ALBANIA MOTOR, COMPANY NIUS K41829010I, konstatoi mangësit si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, në pikën 3, kërkohet:

*“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

---

*etj.*

*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”*

Komisioni Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga OE ALBANIA MOTOR, COMPANY NIUS K41829010I, konstatoi se nuk është plotësuar me të gjithë të dhënat e duhura në përmbushje të kriterit ku ofertuesi deklaroi personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”.

2. Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

*” Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë specifikimet teknike të kërkuara.”*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur katalog/skedë teknike me logo “FORD TRUCKS 3542D”, ku pas krahasimit të të dhënave dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalog, rezultoi se:

- numri i akseve është 3 dhe jo me 2 akse, siç është kërkuar në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga AK (Shtojca 6).
- konfigurimi aksial është 6x4 dhe jo 4x2 ose 4x4, siç është kërkuar në specifikimet teknike të hedhura në SPE nga AK (Shtojca 6).

Gjithashtu, në këtë katalog/skedë teknike nuk ka të pasqyruara të dhëna për Autobotin, i më poshtë:

- Kapaciteti Min 10,000 lt
- Ndërprerës për valët e ujit Min 2 copë
- Të jetë i pajisur me pusët mbi cisternën me diametër min 500 mm
- Të ketë pompë presioni uji
- Autoboti do të përdoret edhe për të larë rrugët nga para dhe mbrapa mjetit

- Pastrimi nga përpara të jetë me presion dhe të kontrollohet nga gabina
- Cisterna të ketë hedhës uji mbi të, për ndërhyrje emergjente në rast zjarri
- Cisterna të ketë bobinë të vendosur në një pjesë që të jetë lehtësisht e përdorshme
- Bobina të jetë e paisur me zorre presioni me diametër min F 20 mm dhe min 15 metra e gjatë
- Të ketë të përfshirë edhe 1 pistoletë presioni për të pastruar rrugët
- Cisterna duhet të parashikojë të ketë dalje për lidhëse me hidrantët e rrugëve të qytetit
- Min 2 copë ndricuese rrotulluese të vendosura mbi kabin
- Min 2 copë zorra, min 20 metra te gjate me diameter min F50 mm sipas standarteve të hidrantëve.
- Shkallë në pjesën fundore të cisternës

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit"*, oferta e operatorit ekonomik ALBANIA MOTOR, COMPANY NIUS K41829010I skualifikohet.

#### ❖ Operatorin ekonomik pjesëmarrës ALMETA GMBH SHPK, me NUIS K22013001U

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës ALMETA GMBH SHPK, me numër NUIS K22013001U, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 8, *"Kriteret e veçanta të kualifikimit"*, *"Kapaciteti teknik"*, në pikën 2.3.1, përcaktohet se:

*"Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 6 000 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës."*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

**a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; dhe,
- ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara.

**b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.”

Për përmbushjen e kësaj pike O.E ALMETA GMBH SHPK ka paraqitur:

- Faturë elektronike nr.359/2024, datë 25.11.2024, me palë blerëse Bashkinë Kamëz.
- Faturë elektronike nr.339/2024, datë 06.11.2024, me palë blerëse Bashkinë Vlorë.

Faturat elektronike të paraqitura nga operatori ekonomik rezultojnë se janë të realizuara me sektorin publik, por të pashoqëruara me Vërtetim të lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, duke mos përmbushur kriterin 2.3.1 gërma a), ku për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

**i.** Vërtetime të lëshuara nga enti publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; **dhe,**

**ii.** Faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e operatorit ekonomik ALMETA GMBH SHPK, me numër NUIS K22013001U skualifikohet.

#### ❖ Operatorin ekonomik pjesëmarrës TIMAK SHPK me NUIS L62030020B.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës TIMAK SHPK me numër NUIS L62030020B, konstatoi mangësit si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, Pjesa II “Shkaqet e përjashtimit”, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit”, në pikën 3, kërkohet:

“Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.”

Komisioni Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të ngarkuar në SPE nga OE TIMAK SHPK me numër NUIS L62030020B, konstatoi se nuk është plotësuar me të gjithë të dhënat e duhura në përmbushje të kriterit ku ofertuesi deklaroi personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”.

2. Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.2, përcaktohet se:

*” Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit, ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë specifikimet teknike të kërkuara.”*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka paraqitur katalog/skedë teknike me logo “TIMAK” dhe me logon «VOLVO», ku rezulton se nuk ka të pasqyruara të dhëna për Autobotin, si më poshtë:

- Autoboti do të përdoret edhe për të larë rrugët nga para dhe mbrapa mjetit
- Pastrimi nga përpara të jetë me presion dhe të kontrollohet nga gabina
- Cisterna të ketë bobinë të vendosur në një pjesë që të jetë lehtësisht e përdorshme

3. Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:

*“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, për mallin (mjetin) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori i autorizuar nga Prodhuesi, duhet të provohet edhe lidhja midis Prodhuesit dhe Distributorit të autorizuar.*

*Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.”*

Në përmbushje të këtij kriteri, OE TIMAK SHPK, ka paraqitur dokumentin me emertimin

“Deklarate\_Prodhuesi\_per\_Superstrukturen”, në përmbajtje të të cilit citohet se:

*“Timak me adresë Tirana Industrial Park, Tiranë, do të prodhojë vetë superstrukturën e autobotit e cila do të montohet në shasinë **Volvo FM11 410 42R Euro 5** që do merret nga kompania Mektrin Trucks si dealer i autorizuar i Volvo Trucks.”,*

por nga ana e operatorit ekonomik nuk është paraqitur autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për të vërtetuar faktin e mesipërm. Në këto kushte, KVO

vlerëson se dokumentacioni i ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3 të Shtojcës 8 të DST-së.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: *"Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit"*, oferta e operatorit ekonomik TIMAK SHPK me numër NUIS L62030020B skualifikohet.

**\* \* \***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE START CO SHPK, me NUIS L11614001S, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 12 877 000 (*dymbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë*) **lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Fier, Lagja "Kastriot", Rruga "Ramiz Aranitasi", Fier, për të lidhur kontratën brenda **10 (dhjetë)** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t'ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO **X** JO ☐

*Nëse Po ( Nr. 1061/2025 Datë 04.08.2025, nr. 1737/9 prot., datë 14.08.2025, i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)*

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
ZYRTARI I AUTORIZUAR**

**Zv.Kryetar**

**Vasil Bregu**